



Prishtinë, 11 nëntor 2010  
Kodi i ZRRE-së: V\_318\_2010

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenin 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (2004/9) të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
- Dispozitat e Nenin 16 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit, KOSTT Sh.a, dhe
- Kërkesën për Aprovimin e Standardeve të Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit, të dorëzuar me datë 27.10.2010 nga Operatori i Sistemit të Transmisionit (në vazhdim OST),

**në seancën e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:**

## VENDIM

- I. APROVOHEN “Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Operatorin e Sistemit të Transmisionit” të KOSTT Sh.a (si në shtojcë të këtij vendimi), të cilat do të fillojnë të zbatohen nga data **1 janar 2011.****

### Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27 tetor 2010 ka pranuar kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST), për aprovimin e dokumentit “Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Operatorin e Sistemit të Transmisionit”.
- Këto standarde janë punuar duke u bazuar në Nenin 16 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe identifikimi dhe përcaktimi i tyre është si rezultat i punës së grupit punues në përbërje të përfaqësuesve nga Korporata Energjetike e Kosovës (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizimi Publik me energji elektrike), Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST), Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) dhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).
- Pas nxjerrjes së draftit të fundit të këtyre Standardeve nga Grupi Punues, këto Standarde OST-ja i ka rishikuar për pjesën që ka të bëjë me OST-n dhe i ka dërguar për aprovim në ZRRE.
- ZRRE e konsideron të rëndësishme që të zbatohen këto standarde nga i licencuari në mbrojtje të konsumatorëve të energjisë elektrike të parapara me ligj, duke pasur parasysh se standardet janë një komponent i rëndësishëm për mbrojtjen e tyre.

- ZRRE ka analizuar dhe vlerësuar këto standarde dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje të këtij vendimi Bordi i ZRRE së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi
- II. Këto standarde do të fillojnë të zbatohen nga i licencuari nga data 01.01.2011, ndërsa monitorimi dhe raportimi i përmbushjes së tyre do të bëhet në përputhje me procedurat e nxjerra nga ZRRE.
- III. Në rast se OST nuk vepron në përputhje me standardet e përcaktuara të kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, ZRRE-ja do të aplikojë gjoba sipas ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullit për Masat Administrative dhe Gjobat dhe licencës së OST-së të lëshuar nga ZRRE. ZRRE nuk do të aplikojë gjoba për vitin e parë të monitorimit.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkëngjitur: **Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Operatorin e Sistemit të Transmisionit.**

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Blerim Koci, Anëtar